



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 29 korrik 2025 , në mbledhjen e XXXVII-të (tridhjeteshtatë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Lirika Maliqi; Sebastina Vokri; Bashkim Sylaj; Mrika Thaçi), lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje e pranishëm ishin edhe; Marigonë Lahu Nënkyetare e Komunës; Saranda Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Lirie Hoti drejtoresh e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, sa i përket kësaj mbledhje rendi i ditës përbëhet nga pesë pika, ku i kemi dy procesverbale të mbledhjeve të KPF-së, raporti i monitorimit të Kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për periudhën janar qershor 2025, pika e tretë ka të bëjë me propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri projekti furnizim me mëshqerra, pika e katërt propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri projekti furnizim me makineri prodhuese për biznese, dhe e kemi pikën e pestë që ka të bëjë me kërkesën e MAPL-së për rishqyrtimin e akteve të Komunës, çështje për të cilën jeni në dijeni që është shqyrtuar në mbledhjen e fundit të Kuvendit dhe ndërlidhen 3 akte e për të cilat siç e keni parë ë material kemi kërkesa nga MAPL për rishqyrtim e tyre, pra janë tri vendime të Kuvendit të Komunës të cilat janë votuar me datë 28.05.2025. Realisht nëse e analizojmë na len të kuptojmë që vendimi fillestar në të cilin kemi ndërhyrë në listën e veçantë të pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për vitin 2025 pra për pronat përkatëse në Zonën Kadastrale Lupç që ka qenë në periudhë afatshkurtër është menduar që të ndryshohet ajo periudhë dhe të bëhet në periudhë afatgjatë, kjo për arsyeje se për 3-4 vite radhazi nuk ka pasur të interesuar për të marr në shfrytëzim atë pronë për afatshkurtër, por që tani sigurisht që janë interesuar investitorët për këtë pronë me qëllim që të marrin në afatgjatë, pra qëllimi ka qenë plotësisht për interes publik për investim dhe zhvillim ekonomik të Komunës tonë, mirëpo MAPL ka vlerësuar në një mënyrë, siç e kemi parë në shkresë, së gjatë vitit nuk mund të ndryshohet dhe plotësohet lista e veçantë e pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim në vitin 2025, sepse parashihet me ligj dhe duhet të publikohen më së largu deri më 31 dhjetor vitit paraprak për vitin pasues, pra MAPL për këtë arsyeje i ka kthyer të pa ligjshme dhe ka kërkuar rishqyrtim të këtij vendimi rrjedhimisht dy vendimet pasuese që ndërlidhen me këtë vendim, andaj në këtë aspekt neve na mbetet që t'i anulojmë këto vendime sepse si të tilla nuk mund të kalojnë tutje, aq më shumë tani kur janë

shpallur edhe zgjedhjet lokale ku sipas ligjeve në fuqi Kuvendi i Komunës dhe Ekzekutivi nuk mund të marrin asnjë vendim lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronave të paluajtshme të Komunës nga dita kur Presidentja shpallë zgjedhjet lokale, mirëpo i mbetet Drejtorisë përkatëse pra Drejtorisë së Pronës që në listën përkatëse që do të vije për miratim në këtë vit, për vitin 2026 prona në fjalë të planifikohet për dhënie në shfrytëzim në periudhën afatgjatë, nëse e sheh të arsyeshme këtë Komuna.

Po ashtu kemi edhe një kërkesë të MAPL-së për rishqyrtim përkatësisht harmonizim të një neni të Rregullores për transparencë të cilën e kemi miratuar në mbledhjen e parafundit të Kuvendit, për të cilën fillimisht ju informoj se arsyeja e mos futjes në rend të ditës me kohë të kësaj pike, është se për këtë kemi pas shumë konsulta, diskutime dhe mospajtime me disa zyrtar të MAPL-së sepse ajo që është rekomanduar si kërkesë për harmonizim, ende konsiderojmë se nuk ka kurrfarë arsye sepse në nenin përkatës të Rregullores janë cekë dispozitat përkatëse ligjore, Ligjet dhe Udhëzimi Administrativ që rregullojnë çështjen e hyrjes në fuqi të një akti të Kuvendit, ashtu siç janë. Pra jemi munduar që të gjejmë një formë që akti në fjalë të harmonizohet pa e sjellë fare në Kuvend sepse në asnjë pikë e as veprim nuk është shkel asnjë dispozitë ligjore, përkundrazi janë përfshirë të gjitha dispozitat dhe ligjet në fuqi që rregullojnë hyrjen në fuqi të një akti të Kuvendit, e që fillimisht ka pas pajtueshmëri të gjendet një formë që me një akt konkluzion, e-mail ose diçka të ngjashme të na njoftojnë që mund ta ndryshojmë, korrigjojmë dhe publikojmë këtë rregullore pa e sjellë në Kuvend, mirëpo në ndërkohë e kanë dhënë arsyetimin që shkresa apo kërkesa për rishqyrtim është nënshkruar nga Ministri dhe nuk mund ta kapërcejmë këtë hap, kështu që na kërkojnë përfundimisht ta sjellim në Kuvend në mënyrë që të korrigjohet neni 47 i Rregullores, afati 15 ditë, të bëhet 30 ditë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, përshëndetje për të gjithë, në foltore e kam përmendur se materialin e parë që e lexove ti Kryesues, ne e kemi thënë këtu në seancë, andaj tani neve na duhet ta arsyetojmë pse e kemi lëshuar mbledhjen, dhe unë për këtë arsyeje erdha sot këtu dhe nuk kam shkuar në punë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nuk dua që t'ia marrë fjalën askujt, por po sqaroj se fillimisht e kemi vetëm për rend të ditës e pastaj kalojmë te pikat përkatëse dhe mund ta merrni fjalën sërish, pra ka të interesuar për të marr fjalën lidhur me rendin e ditës, por jo për pika konkretisht.

z.Haki Rudari, theksoi, përshëndetje për të gjithë, në bazë të materialit që e kemi marr në afatin e rregullt 7 ditor dhe tash po e shohim që e kemi edhe një propozim apo pikë të re të rendit të ditës, pra fjala është për rregulloren për transparencë në Komunën e Podujevës, ne si Grup i LVV e përkrahim dhe e rekomandojmë Kuvendit për miratim, ndërsa sa i përket pikave të tjera e theksoi edhe Kryesuesi i Komitetit por edhe Drejtoresha do të arsyeton se pse është marr vendim kur nuk kemi pasur të drejtë sepse në momentin që shpallen zgjedhjet është e vërtetë që nuk mund të merret asnjë vendim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka të interesuar tjerë për të marr fjalën atëherë e hedh në votim rendin e ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe pikën shtesë të propozuar në fillim të kësaj mbledhje sipas materialit përkatës tani që ju shpërnda, pikë e cila renditet në kuadër të pikës 5, pra 5.4.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, martohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen mbledhjes, përfshirë edhe propozimin që në kuadër të Pikës 5 të përfshihet si pikë shtesë (5.4) edhe Kërkesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtimin përkatësisht harmonizimin e Rregullores për Transparencë e Komunës së Podujevës, sipas rekomandimit të Ministrisë dërguar përmes Shkresës përkatëse të prezantuar në këtë mbledhje dhe bashkëngjitur konstatimeve të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit.

**1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtura më:
27 maj 2025 dhe 25 qershor 2025**

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, miratohen pa vërejtje apo plotësim ndryshime, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes:

-Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për politikë dhe Financa e mbajtur më 27 maj 2025

-Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për politikë dhe Financa e mbajtur më 25 qershor 2025

2. Raport i Monitorimit të Kontratave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (periudha e raportuar janar - qershor 2025) dhe Rekomandimet

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij raporti, theksoi, përshëndetje për të gjithë, në këtë seancë e kemi raportin e Kryetarit të Komunës për monitorimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, mirëpo duhet të bëjë disa përmirësime sepse janë bërë disa gabime teknike për një kontratë që ne si Drejtori kemi menduar që është ende aktive, mirëpo kjo ka qenë në kompetencë të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe është bërë shkëputja e kontratës ku ne nuk kemi qenë të njoftuar, mirëpo ajo kontratë nuk aktive, pra është bërë shkëputja e kontratës dhe nuk figuron në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezi, për çka pas komunikimit me Drejtorin e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural jemi njoftuar se është bërë shkëputja e asaj kontrate, pra fjala është për kontratën e Shoqatës së Gjuetisë ku ata e kanë pas në shfrytëzim një sipërfaqe dhe për shkak të mos pagimit të obligimeve që kanë pasur ndaj Komunës është bërë shkëputja e kontratës.

Materialin e raportit në fjalë me ndryshime mund t'ua përcjellim në e-mail përmes zyrës ligjore.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashtë të hyj në përmbajtje, drejtoresh parafolëse ka qenë e rrugës që jo të na përcjellët tani materialin nëpërmes e-malit por sot duhet ta kishim këtu fizikisht dhe të shohim atë pjesë ku është përmirësuar si dhe po ashtu ta kishim një njoftim nga kjo Drejtori se çka ka ndërhyrë dhe çka ka ndryshuar, pra nuk është në rregull të na thuash se tani ua dërgojmë në e-mail sepse nesër kemi seancë të Kuvendit dhe duke pasur parasysh që kemi një afat të tillë, këto ndryshime dhe këto ndërhyrje që ju i potencuat ka qenë dashtë që paraprakisht ne që jemi këtu t'i kemi para vetës ato që po ndryshohen.

Sido qoftë kjo punë po shkon si po shkon, por duhet t'i jepni më seriozitet këtij Komiteti për punën e tij dhe për kompetencat që ka si dhe që i ka të deleguara nga Kuvendi i Komunës sipas Ligjit për vetëqeverisjes lokale, por në një formë më duket që këtë Komitet e kemi marr si një diçka formale.

z.Bashkim Sylja, theksoi, materialin që ne e kemi marr në pikën dy numri total i kontratave është 20, në sipërfaqen totale të dhënë në shfrytëzim është e treguar edhe për lokalet afariste por edhe për Shoqatën e Gjuetisë si vend gjueti ku qëllimi është shfrytëzimi për afarizëm, kështu që është mirë që në seancën e Kuvendit të na informosh më shumë e nderuar Drejtoresh edhe pse disa informacione i bërë që ajo është një Shoqatë që ka lënë borxhe dhe nuk është më aktive, andaj seancën e Kuvendit është mirë të na tregosh se a ka ndërmarr ndonjë gjë Komuna lidhur me kthimin e borxhit apo hapa tjerë që kanë qenë të nevojshme me qëllim të inkasimit të atyre mjeteve që i ka borxh Shoqata n fjalë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë e pash këtë raport, është një raport i mangët, shumë i shkurtër dhe pa asnjë arsytim duke mos e cekur se ku janë pronat, cilat prona janë, kontratat si dhe çka ka përfituar Komuna nga to si dhe sa kanë mbetur borxh. Ne e dimë që këtu në Kuvend kemi ndarë edhe lokal për Ndërmarrjen "Eko Llapi" ndërsa sot ai lokal shfrytëzohet për tjetër gjë.

Pra me një fjalë ky vetëm raport nuk është, por shpresoj që në mbledhjen e Kuvendit të na jepni më shumë detaje sepse këtu është vetëm një gjysmë faqe, madje këtu duke ju dëgjuar juve drejtoresh, hasa në shumë dilema siç ishte ajo që e ceke se Drejtorin e Bujqësisë e ka shkëput kontratën me Shoqatën e Gjuetisë kurse e theksove se ju si Drejtori e Pronës nuk keni qenë të njoftuar, shtrohet pyetja, ju a nuk jeni duke

folur në mes veti apo pse ndodh kjo gjë sepse po më duket shumë e pa logjikshme kur ti drejtoresh e Pronës nuk e din që drejtoresha e bujqësisë e ka shkëputur kontratën, prandaj ju lus që nesër në seancën e Kuvendit të jeni më të zgjeruar sa i përket raportit sepse ky raport me disa rreshta, veç raport nuk është sepse ne duhet me ditë se çka kemi përfituar si Komunë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron të merr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedhë në votim këtë pikë të rendit të ditës që të rekomandohet për mbledhjen e Kuvendit.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të këtij Raporti, me ndryshim plotësimet e prezantuar nga drejtoresha e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, duke rekomanduar që këtyre konstatimeve t'i bashkëngjitet Raporti përkatës së bashku me plotësim ndryshimet e paraqitura dhe i njëjtë t'iu përcillet anëtarëve të Kuvendit.

3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizim me mëshqerra”

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në kuadër të rendit të ditës propozoj që të miratohet bartja e mjeteve financiare të participimit të fermerëve lidhur me projektin e Drejtorisë që është zhvilluar për furnizim me Mëshqerra.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa e kuptova nga e drejtoresha parafolëse, në rend të ditës e kemi kod të ri ndërsa drejtoresha e theksoi bartjen e mjeteve, por si do qoftë e di se ku është esenca, pra ka të bëjë me participimin e qytetarëve për subvencionet që i marrin.

Sa i përket participimit dihet qëndrimi jon që nga themelimi i këtij Kuvendi edhe atëherë kur për herë të parë ka filluar të aplikohet në vitin e parafundit të ish pushtetit e që atëherë edhe tani ne Grupi i LDK-së gjithmonë kemi qenë kundër dhe do të jem kundër sepse në një formë pjesëmarrja që detyrohen për me qenë përfituesi i subvencioni konsiderojmë që nuk e arrijmë qëllimin për ngritjen e ekonomive familjare gjegjësisht që ta ndihmojmë në zgjerimin e kapaciteteve në këtë rast ekonomitë bujqësore, prandaj si e tillë ne gjithmonë kemi qenë kundër. Pra vetëm të kemi një dallim sepse në kuptimin terminologjik mund të devijojnë gjërat, pra nuk jemi kundër subvencioneve përkundrazi jemi për subvencionim, por ky subvencionim të jetë pa participim, sepse nuk është ndihmë ngase e dimë kur kanë filluar që të subvencionohen bujqit me Mëshqerra e dini edhe ju sa ka kushtuar një Mëshqerrë që një përfitues e ka marrë dhe i ka shkuar mbi 2800 € dhe me 30% i bie që ka paguar mbi 1000€, mirëpo me 1500€ e ke gjetur edhe në treg pa kaluar fare nga procedura për subvencionim apo përfitim.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sa i përket këtij kodi edhe në seancat e kaluara unë kam dhënë sqarim që sa i përket participimit të fermerëve jam kundër që kjo 30% të vazhdoj, mirëpo edhe pot të ndërpritet dhe të mos votohet kjo pikë e rendit të ditës, duhet të dimë se ata që dëmtohen janë bujqit.

Përveç kësaj, unë e kam dhënë edhe një zgjedhje që të bëhet një rregullore ose të ndryshoj ajo aktuale që është, mirëpo si shifër 30% për bujqit është shumë e lartë, dhe e përsëris që edhe të mos përkrahet si propozim vendim mendoj që pastaj dëmtohen bujqit, kurse për të ndryshuar rregulloren duhet një procedurë, pra është mirë që të dini të gjithë që unë jam për t'i mbështetur bujqit por masa prej 30% ose duhet të zvogëlohet ose mund të hiqet krejt dhe është gabim që është vepruar deri sot kështu sepse një bujku po i bie të paguaj shumë me këtë përqindje 30%, dhe fundja po i bie një gjysmë ndihmese për bujkun pasi ata t'i bëjnë ato pagesa, kështu që kjo përqindje ose duhet të bie në rreth 10% ose duhet të largohet krejt, prandaj mendoj se duhet të bëhet një analizë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ekzekutivi për

ta sjellë një rregullore të re, mirëpo për momentin mendoj që më mirë është të votohet në mënyrë që të përfitojnë bujqit sepse në bazë të shënimeve dhe statistikave po del që ka shumë të interesuar dhe është mirë që të ndihmohen bujqit, andaj për shkak të kësaj unë votoj Për.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, dua të bëjë vetëm një ndërhyrje të vogël, dua t'ju pyes sepse unë kam ardhur drejtoresh në këtë Drejtori në fund të vitit 2023 dhe kur kam ardhur e kam gjetur të votuar rregulloren për subvencione, pra pyetja ime është se a e keni votuar ju këtë participim prej 30%, nëse po atëherë unë e konsideroj që kur e keni votuar e keni menduar arsyeshëm dhe saktë se pse po e votoni, kështu që unë besoj që në atë arsyetim që e keni pas qëndron kjo dhe ju jeni pajtuar me këtë.

Participimi prej 30% nuk është shumë e madhe që e dëmton fermerin dhe këtë që po e them është e bazuar në biseda që kam pasur me fermer në vazhdimësi. Edhe unë pajtohem që mund të ekzistoj një hapësirë për të ulur pjesën e participimit por jo të largohet në tërësi sepse konsideroj që do të kishte pasoja më të mëdha se sa kjo që bëhet me 30%, pra e konsideroj që fakti se ata që participojnë me 30% i shton më shumë seriozitetin subvencionit apo ndihmëse që ata marrin si dhe fundja kur po participojnë edhe vetë po ja din vlerën edhe më shumë.

Pjesa tjetër që ishte se sa po i ruajnë subvencionet që po i marrin, ne e kemi krijuar në fillim të vitit një mekanizëm që e bënë monitorimin, ku saktë mund të dal me raporte se sa lëndë i kam dërguar dhe mund t'i sjell procesverbalet e vizitave të monitorimeve që janë duke i bërë. Përveç kësaj e kam edhe planin vjetor dhe e kemi ditë kur i monitorojmë pastaj për dërgimin e tyre në Gjykatë për keqpërdorimin e tyre, kështu që vendimi deri në fund do të jetë që të mos lirohen në tërësi, mirëpo a do të ketë hapësirë për të ulur këtë participim patjetër që do ta shqyrtojmë në një të ardhme të afërt këtë propozim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, unë isha shumë i qartë dhe e theksova që duhet të bëhet një analizë dhe nuk insistova të largohet e tëra mirëpo e ceka që duhet të bëhet një analizë, ndërsa sa i përket votimit të rregulloreve dhe hyrjes në fuqi të tyre e dimë që Kuvendi është për këtë punë, mirëpo nëse nuk zbatohet mirë dhe është e dëmshme për qytetarët dhe bujqit, Kuvendi mund ta ndryshoj sepse për këtë jemi si Kuvend dhe për këtë po insistoj që të bëhet një analizë që të dihet se cila është forma më e mirë duke mos e dëmtuarin fermerin dhe të jetë sa më real shpërndarje e tyre.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, dua t'i përgjigjem drejtoreshës parafolëse të DPKGJ, lidhur me votimin e kësaj rregulloreje sepse unë nuk e kam votuar këtë, dhe pajtohem me kolegun parafolës zotëri Sylja që e potencoj që mund të mos largohet i gjithë participimi, por të ulet në 10%. Pra sa kujtoj rregullorja është votuar në vitin 2018 dhe unë të paktën nuk e kam votuar, kjo sepse e bëri si pyetje drejtoresha parafolëse.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nganjëherë po flasim por edhe ne vet po jemi fajtor, mirëpo unë mendoj që pa participim të fermerëve nuk bënë sepse vijnë këtu persona që ndoshta nuk kanë fare nevojë, kështu që është mirë që të ekzistoj participimi. Nuk dua të bëhem popullsitë, por unë jam që të ketë participim por ndoshta mund të jetë më i vogël se 30%.

z.Naim Çunaku, theksoi, e nderuar drejtoresh e DBPZHR, në kuptimin e sqarimit i bëre disa pyetje dhe e fillova me atë që a jemi ne ata që e kemi votuar, fundja është pak me rëndësi a jemi ne që e kemi votuar apo jo, edhe ne nëse e kemi votuar, situata evoluon dhe fundja vota është dialektike dhe gjithçka ndryshon, dhe ndryshon edhe mendimi për një segment të caktuar, pra po e them sërish që pak ka rëndësi ajo se kush e ka votuar. Se a kanë bërë mirë ata që e kanë votuar dhe sot të votojnë kundër jo, unë kam të drejtë të mbroj qëndrimin tim, ndërsa ti ke të drejtë të mbrosh qëndrimin tënd. Po ashtu e potencova që në bisedë me bujqit vlera prej 30% nuk i dëmton ata, është e vërtetë që një pjesë nuk i dëmton dhe në një formë faza e përzgjedhjes së përfituesve ndoshta edhe të ndihmon sepse për të aplikuar për një Mëshqerrë ai fermer duhet t'i rezervoj të paktën 1000€ për participim e që nuk janë pak sepse nuk është lehtë për ata që merren me bujqësi t'i ndajnë 1000€ për një Mëshqerrë, unë mendoj që dëmtohen.

Në kuptimin që keni bërë një mekanizëm apo formë të punës në Drejtorinë e Bujqësisë që t'i monitoroni se ku kanë përfunduar subvencionet që janë marrë nga Komuna, vërtetë është e vonuar kjo gjë.

Të subvencionosh prodhime bujqësore sigurisht që subvencionimi në rend të parë i ka dy komponentë, e para ka të bëjë me ndërtimin e ekonomive familjare, punësim dhe mirëqenie, ndërsa e dyta është që të siguroj bazë produkteve ushqimore në Kosovë dhe të lirohen nga eksporti, andaj po t'i marrësh subvencionimet që janë bërë në Kosovë dhe sa kanë ndikuar në kuptimin e përmbushjes së nevojave tona në Kosovë vërtetë lë shumë për të dëshiruar, por nuk dua të zgjatem në këtë temë më shumë sepse ka njerëz të cilët janë kompetent për këtë punë.

Në kuptimin e subvencionimit me Mëshqerra, monitorimi i të cilave është dashtë të bëhet më herët, nga njohurit e mija personale që kam hiç pa u interesuar, por duke dëgjuar se çka ka ndodhur, më së paku 5 raste unë i di që nuk i kanë, pra i kanë marr ndokush dhe e ka shitur rrugës, ndokush i ka dal jo produktive dhe atë një pjesë e mirë prej atyre, shembull nëse 100 fermer janë subvencionuar, me plot bindje e them që sot as 50 nuk i kanë prej atyre, dhe zonja drejtoreshë nuk është e ndershme as në aspektin kolegjial dhe në kuptimin e debatit në Kuvend të më thuash duke ndërhyrë nga vendi nuk është e vërtetë kur jam duke diskutuar, e për të më demantuar këtë që po e them unë, ti duhesh të paraqitesh fakte, unë kam fakte që prej 5 mostrave asnjë prej tyre nuk i ka, dhe këtë mendim timin e ndërtova nga ato që unë i kam frekuentuar 5 mostra dhe asnjë prej tyre nuk e ka. Unë të gjitha nuk i kam parë por ata pesë që unë i kam parë asnjë prej tyre nuk i kanë, dhe nuk e thash rastësisht këtë gjë, kurse që ti që po më thua nga vendi se nuk është e vërtetë atëherë ti duhesh të më demantosh me fakte, por jo me fjalë nga vendi, është e vërtetë, nuk është e vërtetë, sepse nuk është kulturë e dialogut.

Edhe një herë e theksoj që ata bujq që unë i shoh dhe i frekuentoj, sepse edhe unë jetoj këtu e kam fqinjë dhe njoh përfitues sepse fundja Podujeva është vend rural, mirëpo për ta përmbylli këtë diskutim e them se sot, nesër edhe dje kam qenë që bujqit nëse mendojmë t'i ndihmojmë duhet t'iu ndërtojmë ekonomi bujqësore të qëndrueshme dhe jo në një formë t'i kushtëzojmë me pjesëmarrje prej 30% sepse për mua është shifër dhe kosto e madhe për një prodhimtari bujqësore.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, atëherë unë kam disa fjalë dhe nuk do ta zgjas shumë, me gjithë respektim që kam për z.Naim Çunaku, dua t'i them që jam Lire Hoti dhe gjithçka që e kam thënë deri sot si drejtoresh e DBPZHR e kam folur me fakte dhe me këtë qëndroj ballëhapur para juve, fermerëve dhe të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës. Në qoftë se kam për t'u krenuar për diçka gjatë pozitës sime si drejtoresh e Drejtorisë në fjalë është për faktin që asnjërit nuk i kam hyrë në hak, por se edhe që e përfundoj punën time me pastërti të madhe.

Sa i përket asaj që e theksove që duhem t'i kem faktet lidhur me atë që e diskutuam dhe unë këtë e dëshmoj tani dhe e dëshmoj edhe në seancat e ardhshme kur do që ju i kërkon do ti keni ato raporte, por pyetja ime ndaj teje i nderuar zotëri Naim është që nëse ti je duke dal para meje sot dhe thua që unë njoh së paku 5 raste të cilat janë keqpërdorur subvencionet, dhe kur kjo më vie nga dikush që është anëtar i Kuvendit kjo nënkupton që ju jeni bashkëpunëtor në një vepër penale të cilit do fermer, në qoftë se ti njeh me fakte këto 5 raste që i theksove dhe deri sot nuk ke ngritur asnjë kallëzim penal, atëherë ti mua sot më tregon që je bashkëpunëtor në një vepër penale të cilit do nga ata 5 fermer.

z.Naim Çunaku, theksoi, drejtoresh doli por ju lus juve që jeni prezent këtu t'ia përcjellni këtë, mirëpo unë edhe vetë do t'i them nesër në seancë të Kuvendit, më vie keq që ajo veproj kështu si veproj, por derisa unë isha duke diskutuar edhe ajo nga vendi më thotë që nuk është e saktë, së pari nuk është kulturë e dialogut dhe i tregova disa herë këtë, pra e përfundoj unë dhe pas asaj mund të del ajo në foltore të tregon se a është e saktë apo nuk është e saktë.

Nëse ajo (drejtoresha e DBPZHR) si profesioniste në drejtësi dhe dëshiron të më tregoj mua se si kualifikohet diçka si vepër penale, këtu ishte absurditeti më i madh i drejtoreshës dhe më vie keq që nuk është këtu por nuk dua që t'ia kaloj meqenëse nuk është këtu. Bashkëpjesëmarrëse në vepër penale mund të jetë vetëm ajo që e ka subvencionuar, unë këtu nuk jam hetues dhe as ndjekës, por unë jam këtu dhe jap llogari për përfaqësim qytetarëve dhe për mbrojtjen e interesave të qytetarëve, këtu përfundon puna ime,

ndërsa privatisht mund të shndërrohem në ndjekës por i kemi organet si Policinë dhe Gjyqësorin që merren me këto gjëra, e jo unë, e përsërisë që bashkëfajtores apo bashkëpjesëmarrëse në një vepër penale mund të jetë vetëm drejtoresha, ai që e financon apo ushqen, por unë as nuk e financoj e as nuk e ushqej.

Krejt në fund po e them se tashmë disi po më jetë si në gjysmë dialogu për vet faktin që drejtoresha në fjalë nuk është e gatshme për mendim ndryshe, dhe faktin që thirret në personale me emër dhe do të doja që t'i tregoja që nuk është forma e punës kjo dhe nuk i bënë nder as Ekzekutivit e as Kuvendit një sjellje si kjo, dhe të thirresh me një pedigree që unë jam këtu dhe se çfarë je ti, tregon sjellja jote që e bëre sot.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe pse drejtoresha e DBPZHR u largua, edhe pse unë edhe vetë ashtu e kam problem të shtyhem me gjininë femërore sepse nuk është në natyrën time, mundem në çdo kohë t'i qesim incizimet që ka rrejt publikisht drejtoresha në fjalë, dhe nuk është aq kristal siç e tha ajo.

Në dëgjim publik në tre vende që e kam dëgjuar unë, në fshatin Bradash kur ka folur e kam dëgjuar në telefon dhe e di se çfarë ju ka thënë fermerëve për dëmet që janë shkaktuar duke ju thënë që brenda një jave ekzekutohen dhe ato kompensime që tri vite nuk kanë dal, pra nuk është ashtu kristal siç tha ajo dhe ne e dimë që Babë e Babagjysh i merren me drejtësi, por nëse ka gabuar ajo le të shkon ta hap një avokaturë por të mos na tregon neve për vepër penale dhe pastaj të ikë (lëshoj sallën).

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse dëshiron ndokush tjetër të marr fjalën, nëse jo atëherë e hedhë në votim këtë pikë të rendit të ditës për rekomandim në Kuvend, së bashku me materialin përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 9 anëtarë të Komitetit sa ishin prezent në sallë, me 5 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti "Furnizim me makineri prodhuese për biznese

z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, në fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, edhe kjo pikë e rendit të ditës ngjason me pikën paraprake, vetëm që ka të bëjë me makineri prodhuese për biznese, andaj propozoi që të përkrahni këtë pikë të rendit të ditës.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin furnizim me makineri prodhuese për biznese.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, në emër të Grupit të LDK e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës për rekomandim në Kuvend.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës për rekomandim në Kuvend, së bashku me materialin përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

5. Kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:

5.1. Vendimi nr.prot.01-463/06-0029235/25 i datës 28.05.2025

5.2. Vendimi nr.prot.01-463/06-0029237/25 i datës 28.05.2025

5.3. Vendimi nr.prot.01-020/04-0029236/25 i datës 28.05.2025

5.4. Rregullorja nr.prot.01-016/01-0029232/25 e datës 28.05.2025

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë në fillim të mbledhjes e bëra një kronologji të këtyre pikave të rendit të ditës, andaj urdhëroni nëse dëshiron fjalën ndokush nga ju lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës dhe njëkohësisht edhe për nën pikën e re që u shtua në fillim të mbledhjes që ka të bëjë me shkresën e MAPL-së rreth Rregullores për Transparencë në Komunën e Podujevës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, dua ti them disa fjalë shkurtimisht sepse nesër është seanca e Kuvendit dhe do t'i themi aty më gjerësisht. Të dëgjova me kujdes i nderuar Kryesues kur e lexove arsyetimin se për çfarë janë kthyer këto vendime nga MAPL. Unë e kam në incizim dhe në procesverbal ku tri herë në emër të Grupit të LDK-së ka folur z.Naim Çunaku dhe ka thënë që nuk bënë sepse nuk është në listë të pronave dhe na keni detyruar ta lëshojmë sallën kurse i keni thirr anëtarët e Kuvendit këtu dhe i'u keni thënë që të votojnë, pra origjinal se si të ka thënë z.Naim Çunaku ashtu e ka kthyer MAPL, dhe nuk e kam shumë të qartë për këto tri pika që i ka kthyer MAPL, a kanë ardhur për tu anuluar apo çfarë të bëjmë sepse nuk jam shumë i qartë për këtë edhe pse e di që MAPL ka thënë rishqyrtim, mirëpo edhe ligji e thekson që prej ditës që Presidenti/ja shpall zgjedhjet lokale nuk kemi të drejtë të marrim vendime për dhënie të pronave në shfrytëzim, megjithëse kjo seancë ka qenë me 28 maj dhe nuk ka qenë ky problem, por problemi ka qenë që nuk ka qenë në listë të pronave për dhënie shfrytëzim kur e kemi votuar në fund të vitit 2024.

Unë pasi kam dal jashtë salle në atë mbledhje jam kthyer të marr materialin këtu në sallë edhe ti zotëri Kryesues dhe drejtoresha e DPKGJ më keni thënë mua që të votoj, dhe unë ju kam thënë që po e votoj atë listën tjetër për t'i heqë pronat nga privatizimi / AKP që të shpallen interes i përgjithshëm, ndërsa e kam cekë që këtë vendim nuk e votoj, sepse kam dyshuar dhe nuk e kam votuar, dhe jam i lumtur për këtë.

z.Naim Çunaku, theksoi, po të isha në vendin e Kryesuesit dhe disa këtu që e kanë votuar këtë vendim do të isha ndier keq, arsyeja pse është që gjërat që ti i nderuar Kryesues i lexove si arsye të Ministrisë, mund ta marrësh dhe ta lexosh procesverbalin, fjalët e mia i ke, të njëjtat duke ju thënë që mos e votoni sepse jeni duke e shkel Ligjin, dhe për inati që unë e kam arsyetuar ju jeni dal në korridore duke thënë që LDK po e lëshon seancën dhe ju kemi thënë në foltore mos na shtini që ta shkelim kushtetutën, e ju shkelni ligjin sepse çdo kush e ka për veti, por neve mos na shtini të shkelim ligjin.

z.Haki Rudari, theksoi, në parim kanë të drejtë parafolësit sepse kështu thotë materiali, ndërsa kur e them që nuk kanë të drejtë e them në atë që jemi anëtarë të Kuvendit e jo zyrë ligjore e as MAPL.

Është e vërtetë që i lexoj dhe i njoh rregulloret, por nuk jam jurist i kualifikuar dhe i thirrur në kuptimin se kjo është kështu e kjo është ashtu, nuk është mirë të kthehen kështu vendimet por kjo ka ndodhur, përgjegjësia normalisht që është e jona që e votojmë por është edhe e mekanizmave tjerë dhe është e vërtetë që kur vijnë këto pika në Kuvend duhet të shqyrtohen më mirë dhe të trajtohen më mirë.

Mirë e dimë që vendimet e MAPL-së janë përfundimtare dhe kam thënë edhe kur ka qenë keq dhe mirë i kam përkrahur këto vendime dhe nuk kam qenë asnjëherë kundër, edhe në këtë rast ka ardhur kështu nga MAPL dhe duhet të pajtohem me këtë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, pajtoj plotësisht me mendimin e z.Haki Rudari që këtu problemi kryesor është që këta po nguten kur po i bëjnë pikat e rendit të ditës, në momentin e fundit e bëjnë një rend të ditës dhe e dërgojnë pa e shqyrtuar mirë dhe zyra ligjore që të paktën t'ju jep asistencë Drejtorive dhe është e obliguar, mirëpo drejtori kur te bënë pikën e rendit të ditës duhet të konsultohet me zyrën ligjore, kështu që mos të na qesin neve në lajthitje sepse neve po na thuhet që duhet të kthejmë këtë pronë në interes publik sepse e merr AKP, e tash çfarë të bëjmë ne t'ia lëm AKP-së apo ta marrim ne.

Tani a është mundësia vetëm t'i anulohet këto vendime apo ndonjë mënyrë tjetër, e po këta të ishin më vigjilent këto prona ndoshta nuk ishin humbur.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, kjo çështja ka të bëjë me pronën në fshatin Lupç. E di që LDK e ka kundërshtuar dhe ne kemi qenë me një rezervë, mirëpo ajo pronë ka qenë për afatshkurtër dhe qëllimi ka qenë që asaj prone t'ia zgjasim afatin për shkak se ka pasur biznese të interesuara për ta marr në shfrytëzim afatgjatë atë pronë, edhe kështu nuk ka kaluar ligjshmërinë në Ministrinë përkatëse, kështu që e kemi sjell këtu në Kuvend dhe po e anulohet këtë vendim së bashku me ato vendimet përcjellëse që ndërlidhen me të, kurse Drejtorisë përkatëse i mbetet që në listën e pronave për vitin 2026, këtë pronë ta vendos për periudhë afatgjate, pra ky ka qenë problemi dhe kjo pronë prapë mund të hyjë në listë për vitin e ardhshëm në mënyrë që të jetë në periudhë afatgjate.

z.Bashkim Sylaj, theksoi, më duket se u keqkuptova këtu nga ju sepse unë e thash atë që në parim pikat e rendit të ditës kur të sjellën në Kuvend duhen të përgatiten, pra të konsultohen mos të kenë gabime drejtshkrimore e që për këtë është kthyer nga MAPL, pra kjo ishte si kritikë dhe nuk ka lidhje për cilën pronë është fjala.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ne e dimë se si shkon kjo punë ndokush nga lart i thotë kryeni ju punën sepse unë e kam njërin atje dhe kryhet puna, përveç kësaj unë mendoj që edhe ti zotëri Kryesues e ke ditur saktë sepse ligji për dhënie në shfrytëzim të pronave e tregon shumë saktë që duhet të jetë në listë të vitit paraprak si pronë e votuar, ne e dimë që e kemi votuar për atë pronë por kemi votuar për afatshkurtër pra deri në 15 vite, e tash nuk mund ta ndërrosh por duhet ta presësh fundin e vitit por vijnë anëtarët e ri të Kuvendit dhe e votojnë për afatgjatë, mirëpo ne tani nuk kemi pasur mundësi ta bëjmë këtë.

Ju e dini që pasi kam dal nga salla jam kthyer në sall për ta marr materialin më keni thënë që të votoj dhe ju kam përgjigjur që për propozimin që ka të bëjë në interes përgjithshëm me AKP e votoj, ndërsa këtë propozimin tjetër nuk e votoj për arsye ligjore dhe më vie shumë mirë që e ka kthyer Ministria kështu.

Pak dyshoj edhe te kolegu z.Haki Rudari sepse e kanë vë para aktit të kryer, përndryshe zotëri Rudarit nuk i kapërcejnë këto gjëra sepse kur e dërgoni materialin ai saktë e shikon se në çfarë ligji jeni thirrë sepse ky lexon shumë mirë ligjin dhe materialin, pra edhe e ka ditë këtë por nganjëherë bënë të dal edhe kundër partisë edhe pse tash më është kaluar kështu.

z.Naim Çunaku, theksoi, e nderura drejtoresh e DPKGJ, nuk ishe këtu më herët dhe dua që të them që ndihem shumë keq kur vendimet e këtij Kuvendi nuk plotësojnë kriteret ligjore dhe detyrohet dikush të na i revidoj, pra nuk ndihem mirë pavarësisht që mund të jemi subjekte të ndryshme sepse fundja pjesë e vendimmarrjes së Komunës së Podujevës jam edhe unë qoftë me votë Pro apo Kundër, pra po e përsërisë që jam pjesë e vendimmarrjes. Pastaj shpesh po theksojmë që nuk jemi të fushës së drejtësisë mirëpo është procedurë ajo, pra në atë ku je thirrur në vendim për dhënie në shfrytëzim unë në foltore të kam thënë që nuk mundemi tani ta ndryshojmë sepse nuk është në listën kur e kemi miratuar në dhjetor të vitit kaluar, mirëpo keni dashtë që të provoni por vërtetë është keq zotëri Kryesues të kthen gjithë këto vendime nga një seancë dhe mua nuk më bën që të ndihem mirë, por dikush ndoshta është mësuar.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse dëshiron ndokush tjetër të marr fjalën, nëse jo atëherë e hedhë në votim këtë pikë të rendit të ditës për rekomandim në Kuvend, së bashku me materialin përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit, konstatoi se nga 8 anëtarë të Komitetit sa ishin prezent për momentin në sallë, me 4 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur, Kuvendit të Komunës i rekomandohet rishqyrtimi i tri vendimeve sipas kësaj pike të rendit të ditës (5.1; 5.2; 5.3) konform Kërkesave dhe rekomandimeve përkatëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, bashkëngjitur materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesuesi i Komitetit, vazhdoi, po ashtu e kemi edhe nënpikën 5.4 e cila hyri pikë shtesë që është Rregullorja për transparencë komunale, akt i cili siç e ceka në fillim është kthyer nga MAPL vetëm për shkak të nenit 47 për arsye se ka qenë afati 15 ditë i hyrjes në fuqi kurse kanë rekomanduar të bëhet 30 ditë, mirëpo vlen të ceket se me të njëjtën dispozitë dhe me këtë afat 15 ditë kemi pikat tjera që kanë kaluar ligjshmërinë në Ministri, ndërsa kjo nuk ka kaluar për shkaqet siç i keni parë në Shkresën e MAPL-së sipas të cilës kërkohet të përmirësohet nesër në mbledhjen e Kuvendit nesër.

z.Naim Çunaku, theksoi, dua që të theksoj që veshi jem nuk e pranon kur ti Kryesues e thua që e ka kthyer vetëm për këtë sepse vetëm për një faj të vogël kushedi se çfarë dëmi bënë, për një prejse e kanë pushkatuar njeriun, kështu që të gjithë ne këtu e kemi nga pak shkollë dhe nuk mund të justifikohet që në vend të afatit prej 15 ditë të kishte qenë 30 ditë, sepse e kam thënë atë ditë kur është miratuar kjo Rregullore në Kuvend se duhet ta shikoni se për sa ditë duhet të jetë në diskutim publik dhe aty shkruan 30 ditë, andaj nuk është defekt i vogël nëse ti e ke shkurtuar mundësin nga 30 ditë në 15 ditë, pra është defekt dhe po të ishte kaq minor ky defekt nuk do ta kthente Ministra në rishqyrtim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj çështje, nëse jo e hedhë në votim për rekomandim në Kuvend, së bashku me materialin përkatës të prezantuar në fillim të kësaj mbledhje dhe i cili do t'iu dërgohet anëtarëve të Kuvendit bashkë me konstatimet e kësaj mbledhje të KPF-së.

Po ashtu, pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e Komitetit, Kuvendit të Komunës i rekomandohet rishqyrtimi, përkatësisht harmonizimi i Rregullores për Transparencë e Komunës së Podujevës të miratuar në mbledhjen e datës 28.05.2025, dhe atë sipas Kërkesës dhe rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal përcjellur përmes Shkresës e cila i bashkëngjitet konstatimeve nga mbledhja e KPF-së.

Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;

Enis Sheholli

Arbrim Idrizi

Nr.Prot.01-325/05-0044313/25

Podujevë,

29 korrik 2025

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha